



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e enjte, në datën 29 gusht 2019, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Piro</b>	<b>MISHA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, shqyrtoi çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

1. Shtyrjen e afatit të mbylljes së transmetimeve analoge në Qarqet Tiranë, Durrës dhe Vlorë, me 30 ditë.
2. Operatorët ekonomike në treg, kryesisht platformat audiovizive të cilët tregtojnë dekodera, të vënë në dispozicion të AMA-s informacionin e kërkuar në mënyrë të përsëritur, lidhur me sasinë e dekoderave që disponojnë.
3. Operatorët privatë kombëtare të cilët ende nuk mbulojnë me sinjal numerik zonat urbane (Bashkitë Sarandë, Himarë), të marrin masa të menjëhershme për shtrimin e infrastrukturës digjitale edhe në këto zona.
4. T'i drejtohet qeverisë me kërkesën për ngritjen e menjëhershme të Komitetit Ndërinstitucional për zbatimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike, për ndjekjen e procesit të digjitalizimit, i cili nuk është funksional që prej shtatorit 2017.
5. Pranimin e kërkesës për përfshirjen në paketën programore të RTSH-së të programit "RTSH Agro" në vend të "RTSH Plus" dhe rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin në paketën programore të "RTSH Fëmijë 2" me "RTSH Plus". (**Vendimi nr. 117, datë 29.08.2019**)

**Tiranë, 29 gusht 2019**

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**